

UDHËZIM
I
PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

Nr. 34 Dt 8. 4. 1999

Sot me dt.07.04.1999, unë Prokurori i Përgjithshëm Arben Rakipi me qellim për te Ndhmuar ne përmirësimin e cilësisë se hetimeve, marrëdhënieve ligjore ndërmjet prokuroreve dhe oficerëve te policisë gjyqësore, te përgatitjes se prokuroreve për gjykim dhe njohjes se thelle te fashikujve hetimore e gjyqësore, bazuar ne nenin 24 te Kodit te Procedurës Penale

UDHËZOJ:

1. Nevoja e sigurimit te një hetimi te plote, te gjithanshëm dhe objektiv, kërkon, para se gjithash, te kuptuarit e pergjegjesise qe prokuroret kane për hetimin e ceshtjeve penale.

Këto te fundit janë objekt i punës se prokurorit dhe është prokurori ai qe mban përgjegjësi për fatin e ceshtjes. Te gjitha strukturat e tjera ndihmese te prokurorit janë ne varësinë funksionale dhe drejtohen prej tij. Ne këtë kuptim, është prokurori ai qe krijon mundësi dhe hapësira për hetimin duke drejtuar ligjërisht oficeret e policisë gjyqësore sipas një plani te paramenduar. Mjaft shpesh, ne praktiken hetimore, vihet re qe prokuroret nuk kane dijeni për përmbajtjen e hetimit, nuk janë ne kontakt me ceshtjen ne këtë faze, lënë detyra, ne qofte se mund te quhen te tilla, mjaft te përgjithshme për oficeret e policisë gjyqësore me shprehje te tilla si "te kryhet çdo veprim qe quhet i nevojshëm".

Ky lloj delegimi, qe ne thelb është shkelje e nenit 304/1 te Kodit te Procedurës Penale pasi urdhri i tille le shteg për mosdrejtimin e hetimit, krijon pasoja te dëmshme ne gjetjen e se vërtetës, pasi hetimi merr drejtim te pa kontrolluar, rastësor dhe zhvillohet nga persona qe, si rregull, janë me pak profesionale sesa prokuroret. Me pas, ne përfundim te hetimeve te bëra sipas urdhër delegimeve te tilla, krijohet përshtypja qe dosja nuk njihet mire ne detaje nga prokurori dhe, për rrjedhoje, paraqitja e tij ne gjykim le për te dëshiruar.

Për te evituar apo minimizuar këto pasoja qe jo rralle vijnë nga neglizhenca gjate kryerjes se detyrës, është e domosdoshme qe te kuptohet e me pas te zbatohet korrektesisht neni 304 i Kodit te Procedurës Penale.

2. Është e detyrueshme, ne kuptim edhe te nenit 304 te Kodit te Procedurës Penale dhe frymës se përgjithshme qe ndjek ligja jone procedurale, qe, me te marre materialin nga policia apo aktet e vendit te ngjarjes, prokurori te lere detyra te specifikuar ne aktin e delegimit te veprimeve për oficerin e policisë gjyqësore. Ne këtë rast, prokurori duhet te përmendë ne detaje jo vetëm personat qe do te

pyeten, por edhe perse do te pyeten dhe si mund te verifikohen thëniet e tyre. Ne akt duhen caktuar edhe afate te shkurtra, jo me tepër se 1 (një) jave, brenda se cilës veprimet duhen kryer. Ne rastet kur duhet te mblidhen dokumente, duhet treguar lloji i dokumenteve dhe vendi ku gjenden ato.

Te gjitha sa me sipër duhet te jene te shkruara, dhe, ne përfundimin e javës, oficeri i policisë gjyqësore duhet te relatoje me shkrim tek prokurori se cfare ka bere, cfare jo dhe pse nuk i beri. Nga ana e tij prokurori pas studimit te materialeve ,po me shkrim, le detyra te reja dhe afate te shkurtra. Kur veprimtaria e oficerit te policisë gjyqësore zvarritet pa shkak, prokuroret duhet te informojnë titullarët e tyre.

Do te ishte pozitive qe prokuroret te marrin pjese apo te kryejnë vete veprime te rendesise kryesore për ceshtje te caktuara. Kjo do te bënte me te mundur përfshirjen e tyre ne thelbin e hetimit dhe me pas mundësi me te mëdha për te përfaqësuar me sukses ceshtjen përpara gjykatës.

3. Mungesa e interceptimit te sakte te materialit kallëzues apo akteve te vendit te ngjarjes, e shoqëruar me akte te delegimit te bëra nga prokurori jo konform nenit 304 te Kodit te Procedurës Penale, çon jo vetëm ne devijime te zgjidhjes se drejte te ceshtjes, por edhe, siç vihet re rëndom, ne zgjatje te pafundme te hetimeve.

Është për tu theksuar qe zgjatja e afatit te hetimeve, sipas nenit 324 te Kodit te Procedurës Penale, është rast i veçante dhe lejohet si rregull për hetime voluminoze, te vështira apo kur hetohet për procedime te lidhura me juridiksione te tjera.

Ne këto kushte, përpara se te vendoset për zgjatjen e afatit te hetimeve, oficeri i policisë gjyqësore qe heton ceshtjen duhet te beje një relacion te shkruar ne te cilin te shpjegoje arsyet pse kërkohet zgjatja e afatit, arsyet pse ceshtja nuk u hetua ne afat dhe përpjekjet qe janë bere për te përfunduar ceshtjen ne afat.

Mbi këtë baze, prokurori do te gjykoje me drejt lidhur me nevojën e zgjatjes se afatit dhe pergjegjesise e oficereve te policisë gjyqësore ne mos kryerjen e detyrave te tyre,


Ne këto raste prokurori qe zgjat afatin te vere ne dijeni prokurorin titullar ndërsa një kopje e këtij vendimi te dërgohet për dijeni ne Prokurorinë e Përgjithshme.

4. Ne ceshtjet e flagrancës ne asnjë rast nuk duhet lejuar qe hetimi te zgjatet dhe aq me tepër te arrije kufijtë e afateve te caktuara ne nenin 323 te Kodit te Procedurës Penale. Këto ceshtje duhen përfunduar menjëherë dhe te dërgohen ne gjyq sa me shpejt.

5. Ky udhëzim te punohet ne kolektivat e prokurorive dite te dërgohet njoftim ne Drejtorinë e Hetimit dhe Kuadrit për marrjen dijani.
6. Nga një kopje e tij t'u jepet edhe prokuroreve ne Prokurorinë e Përgjithshme.
7. Një kopje e tij t'i dërgohet për dijani Ministrit te Rendit Publik për t'ja bere te njohur vartësve te tij.
8. Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

PROKURORI I PERGJITHSHEM

ARBEN RAKIPI

Handwritten signature of Arben Rakipi in black ink, written over the printed name.

